

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00Nr.Br.185 /2022	Data: Datum: 29.12.2022	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika c, nenit 68 paragrafi 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 të datës 30.10.2010 në mbledhjen e mbajtur me datë 29.12.2022 merr këtë vendim:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT 01Nr.23/2014 të datës 31.03.2014 PËR THEMELIMIN E VEND GJUETISË SË PËRBASHKËT "ISTOGU"

1. MIRATOHET anulimi i Vendimit të Komunës, 01Nr.23/2014 të datës 31.03.2014 për themelimin e vend gjuetisë së përbashkët "Istogu".
2. Qëllimi i anulimit të këtij vendimi është se në vendimin 01 Nr.23/2014 të datës 31.03.2014 për themelimin e vend gjuetisë së përbashkët "Istogu" si vend gjueti është paraparë i tërë i komunës së Istogut me sipërfaqe prej 45,385.00 hektarë tokë ku janë të përfshira vendbanimet, pjesa e parkut kombëtar dhe si i tillë nuk ka mund të zbatohet.
3. Ligji për Gjuetinë Nr.02/L-53 i miratuar në janar të vitit 2007, e parasheh themelimin e vend gjuetisë në nenin 19 paragrafi 19.2 dhe 19.4 dhe neni 17 i këtij ligji e parasheh sipërfaqen për themelimin e vend gjuetisë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij në Kuvendin e Komunës së Istogut, dërgimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal-MAPL, siç është e përcaktuar me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 17 të Rregullores Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit të Komunës së Istogut.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DIREKTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

00 - 10 - 033 Datum 06.01.2023

ISTOG-ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit,
 z. Enver Rugova



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00Nr.Br.185/2022	Data: Datum: 29.12.2022	

Skupština opštine na osnovu člana 12, stav 12.2 tačka c, člana 68 stav 68.3 Zakona o lokalnoj samoupravi 03/L-040, (Službeni list Republike Kosovo br. 28/2008) i Statuta Opština 01 br.62/10 od 30.10.2010.godine na sednici održanoj 29.12.2022 donese sledeću:

O D L U K U

ZA UKIDANJE ODLUKE 01 br.23/2014 od 31.03.2014.godine O OSNIVANJU ZAJEDNIČKOG LOVIŠTA "ISTOGU"

1. USVAJA SE ukidanje Odluke Skupštine opštine 01 br.23/2014 od 31.03.2014.godine za osnivanje zajedničkog lovišta "Istogu".
2. Svrha ukidanja ove odluke je da se Odlukom 01 br. 23/2014 od 31.03.2014.godine o osnivanju zajedničkog lovišta „Istog“, kao lovišta, koje je predviđeno na teritoriji cele opštine Istok, sa površinom od 45.385,00 hektara zemljišta, gde su naseljena mesta, deo nacionalnog parka, i kao takva nije mogla da se realizuje.
3. Zakon o lovstvu br. 02/L-53, usvojen u januaru 2007, predviđa osnivanje lovišta u članu 19, stav 19.2 i 19.4, a član 17 ovog zakona predviđa područje za osnivanje lovišta.
4. Za sprovođenje ove Odluke odgovorni su: Predsednik Opštine, Direkcija za Poljoprivredu, Šumarstvo i Hidro ekonomiju.
5. Ova Odluka stupa na snagu odmah, nakon usvajanja u Skupštini Opštine Istok, upućivanjem Ministarstvu za administraciju lokalne samouprave - MALS, kako je definisano članom 81. Zakona br. 03/L-040, za lokalnu samoupravu, član 17 Uredbe br. 02/2021, za postupak izrade i objavljivanja opštinskih akata, a nakon javnog oglašavanja, na oglasnoj tabli, ili na zvaničnoj internet stranici opštine.

Kopijom ove odluke obavestiti: Ministarstvo administracije lokalne samouprave, Predsednika opštine, Direkcija za Poljoprivredu, Šumarstvo i Hidro ekonomiju, i kopija ostaje u arhivi Skupštine opštine Istok.

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-1230/022	Data: Datum: 29.12.2022	

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 58, pika h) e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 68, paragrafi 68.1, pika 8 e Statutit të Komunës 01 Numër 62/10 të datës 30.11.2010, për anulimin e vendimit 01 Nr.23/2014 të datës 31.03.2014, për themelimin e Vend gjetisë së përbashkët “Istogu” dhe Kuvendit të Komunës i:

P R O P O Z O N

Kuvendit të Komunës, që duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës 01 Numër 62/10 të datës 30.11.2010, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.12.2022 të merr këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT 01Nr.23/2014 të datës 31.03.2014 PËR THEMELIMIN E VENGJUESISË SË PËRBASHKËT “ISTOGU”

1.TË MIRATOJ: Anulimin e vendimit 01 Nr.23/2014 të datës 31.03.2014, për themelimin e Vend gjetisë së përbashkët “Istogu”.

2. Qëllimi i anulimit të këtij Vendimi është se në vendimin 01 Nr.23/2014 të datës 31.03.2014, për themelimin e Vend gjetisë së përbashkët “Istogu”, si vend gjeti është paraparë i ter territori i komunës së Istogut me sipërfaqe prej 45,385.00 hektar tokë ku janë të përfshira vendbanimet, pjesa e parkut kombëtar dhe si i tillë vendimi nuk ka mund të zbatohet.

3. Ligji për Gjuetinë Nr.02/L-53 i miratuar në janar të vitit 2007, e parasheh themelimin e vend gjetisë në neni 19 paragrafi 19.2 dhe 19.4 dhe neni 17 i këtij ligji e parasheh sipërfaqen për themelimin e vend gjetisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, dërgimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal–MAPL, siç është përcaktuar në nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 17 të Rregullores Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Kuvendit të Komunës,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.23/2014	Data: 31.03.2014	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 19. paragrafi 19.2. dhe paragrafi 19.4. të Ligjit për Gjuetinë, Ligji Nr.02/L-53, në mbledhjen e mbajtur më: 31.03.2014, shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për themelimin e Vendgjuetisë së Përbashkët "Istogu", në territorin e Komunës së Istogut dhe mori këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Vendgjuetia e përbashkët "Istogu" për tërë territorin e Komunës së Istogut në sipërfaqe të përgjithshme prej 45,385.00 ha, e cila shtrihet dhe përfshinë pjesën pyjore në veri të Komunës së Istogut, të përcaktuar në kufijtë të paraqitur në hartën I. e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
- II. Vendgjueti e përbashkët, e përcaktuar në Pikën I të këtij Vendimi, është e tipit të hapur dhe në të janë të pranishme llojet e kafshëve të egra dhe kafshëve të egra të cilat janë në mbrojtje të posaçme, të paraqitur në elaboratin e arsyshmerisë së shpalljes së vendgjuetisë së përbashkët, e cila po ashtu është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
- III. Obligohet Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, që të pas miratimit të këtij Vendimi, të procedojë më tutje në pajtim me Ligjin Nr.02/L-53 për Gjuetinë dhe Udhëzimin Administrativ MA-Nr.10/2007, për Kriteret e caktimit të Zonave dhe Procedurave për Themelimin e Vendgjuetive.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

K r y e s u e s i,
Hazbi Bajra

